

"EMN"
"SARAJEVI"-5

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-7939
Më 2.7.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 2.7.2013 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Administratës, për lejimin e shpalljes së tenderit për furnizim me material për mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit si dhe të sistemit të ngrohjes qendrore në objektet e Komunës së Prizrenit, dhe mori këtë


KON KL U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Administratës, i datës 24.6.2013, për lejimin e furnizimit me material për mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit si dhe të sistemit të ngrohjes qendrore në objektet e Komunës së Prizrenit, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Administratës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Administratës, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Mija

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-7939
Më 2.7.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 2.7.2013 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Administratës, për lejimin e shpalljes së tenderit për shtypjen dhe prarimin e logove të reja për nevojat e Komunës, dhe mori këtë


K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Administratës, i datës 24.6.2013, për lejimin e shtypjes dhe prarimit të logove të reja për nevojat e Komunës, përkatësisht për shtypjen dhe prarimin e 200 logove me kuti mbajtëse (futrolla) të dimensioneve të vogla, si dhe për shtypjen dhe prarimin e 50 logove me kuti mbajtëse (futrolla) të dimensioneve më të mëdha, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Administratës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Administratës, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-7939
Më 2.7.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur, më 2.7.2013, me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike për lejimin e shpalljes së tenderit për ndërtimin e rrugëve lokale në fshatin Billushë, dhe mori këtë

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, i datës 20.6.2013, rreth lejimit të ndërtimit të rrugëve lokale në fshatin Billushë, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-7939
Më 2.7.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur, më 2.7.2013, me drejtorinë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike për lejimin e shpalljes së tenderit për ndërtimin e urës në fshatin Korishë, dhe mori këtë

KON KLUZION


Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, i datës 25.6.2013, rreth lejimit të ndërtimit të urës në fshatin Korishë, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna e Prizrenit

Kryetari i Komunës

Nr. 01/06-7939

Më 2.7.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur, më 2.7.2013, me drejtorinë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike për lejimin e shpalljes së tenderit për ndërtimin me elemente të betonit të disa rrugëve lokale dhe kanalizimeve, me participim, dhe mori këtë

KONKLuzion

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, i datës 14.6.2013, për lejimin e ndërtimit me elemente të betonit të disa rrugëve lokale dhe kanalizimeve, me participim, në Komunën e Prizrenit, kështu që, për këtë qëllim, lejohet shpallja e tenderit për ndërtimin e:


1. Kanalizimit në rr. "Raguza",
2. Rrugës në fshatin Nashec-Lagja Gutaj,
3. Rrugës "Hajdar Shala",
4. Rrugës "Skender Latifi",
5. Rrugës lokale në fshatin Jabllanicë,
6. Rrugës "Selajdin Berisha" 3,4,
7. Rrugës "Beamir Memaj",
8. Rrugës "Emin Abazi-1",
9. Rrugës "Elbasani -1",
10. Rrugës lokale në fshatin Gjonaj,
11. Rrugës lokale në fshatin Kushnin të Hasit, dhe
12. Rrugës në lagjen "Badallaj", Prizren.

Për realizimin e këtyre projekteve, Komuna e Prizrenit do të participojë me 70 % të vlerës së projektit, ndërsa komuniteti me 30 %.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbime Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbime Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-8192
Më 2.7.2013

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, rreth lejitimit të udhëtimit zyrtar për në Durrës dhe pagesës së mëditjeve për Fahrije Bytyqin, drejtoreshë e DPMS, kryetari i Komunës, më 2 korrik 2013, miratoi këtë:

V E N D I M

Neni 1

Lejohet udhëtimi zyrtar i Fahrije Bytyqit, drejtoreshë e DPMS, për në Durrës të Republikës së Shqipërisë, me qëllim të pjesëmarrjes në punëtorinë që ka të bëjë me diskutimin e draftit të parë të Strategjisë së Kolegjiut për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. Punëtorja do të mbahet nga data 11 korrik deri me 13 korrik 2013, kështu që për këtë qëllim lejohet udhëtimi zyrtar dhe pagesa e mëditjeve, për të lartcekurën.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve.

Neni 3


Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, e lartcekura, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-7939
Më 2.7.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur, më 2.7.2013, me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Zyrës për Komunitete dhe Kthim të datës 25.6.2013, për lejimin e shpalljes së tenderit për furnizim me material ndërtimor për renovim të shtëpive të rasteve sociale nga radhët e minoriteteve, dhe mori këtë


KON KLUZION

Miratohet propozimi i Zyrës për Komunitete dhe Kthim i datës 25.6.2013, për lejimin e furnizimit me material ndërtimor me qëllim të renovimit të shtëpive të familjeve të evidentuara si rasteve sociale nga radhët e minoriteteve të komunës së Prizrenit, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Zyra për Komunitete dhe Kthim dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Zyra për Komunitete dhe Kthim, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-7939
Më 2.7.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 2.7.2013 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë për Emergjencë dhe Siguri, për ofrimin e shërbimeve zjarrfikëse me burime njerëzore, dhe mori këtë


K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë për Emergjencë dhe Siguri, i datës 2.7.2013, për ofrimin e shërbimeve zjarrfikëse me burime njerëzore gjatë muajve të verës, kështu që për këtë qëllim lejohet zhvillimi i procedurave të nevojshme ligjore.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Zyra e Personelit, Drejtoria e Emergjencës dhe Sigurisë dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Zyra e Personelit, Drejtoria e Emergjencës dhe Sigurisë, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-7939
Më 2.7.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur, më 2.7.2013, me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor për lejimin e shpalljes së tenderit për hartimin e Planit Rregullues Urban-“Lakuriqi Verior 2”, dhe mori këtë


K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, i datës 25.6.2013, rreth lejimit të hartimit të Planit Rregullues Urban-“Lakuriqi Verior 2”, ku është paraparë ndërtim i lartë, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-7939
Më 2.7.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur, më 2.7.2013, me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor për lejimin e shpalljes së tenderit për hartimin e Planit Rregullues Urban-“Gjelbërim me përmbajtje dhe rikrijim”, dhe mori këtë

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, i datës 25.6.2013, rreth lejimit të hartimit të Planit Rregullues Urban-“Gjelbërim me përmbajtje dhe rikrijim”, i bazuar në PZhU, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-8193
Më 2.7.2013

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Administratës, për lejimin e mjeteve financiare për mbulimin e pjeshëm të shpenzimeve të mjekimit, për Azar Mustafi, shërbyes civil në Komunën e Prizrenit, kryetari i Komunës më 2 korrik 2013, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Administratës, për lejimin e mjeteve financiare për mbulimin e pjeshëm të shpenzimeve të mjekimit, për Azar Mustafi, shërbyes civil në Komunën e Prizrenit, kështu që, për këtë qëllim, dhe në emër të mbulimit të pjeshëm të shpenzimeve të mjekimit (intervenim kirurgjik në zemër), lejohen mjetet e nevojshme financiare në shumën 1000 €.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Administratës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Administratës, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, i lartcekuri, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-8194
Më 2.7.2013

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, për lejimin e udhëtimit zyrtar për në Ohër dhe pagesës së mëditjeve për Sherife Çengajt, zyrtare komunale, kryetari i Komunës, më 2 korrik 2013, miratoi këtë:

V E N D I M

Neni 1

Lejohet udhëtimi zyrtar i Sherife Çengajt, zyrtare komunale, për në Ohër të Maqedonisë, me qëllim të pjesëmarrjes në trajnimin me temën: “Marketingu Rajonal dhe Brendingu”. Trajnimi do të mbahen nga data 3 korrik deri me 6 korrik 2013, kështu që për këtë qëllim lejohet udhëtimi zyrtar dhe pagesa e mëditjeve, për të lartcekurën.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve.

Neni 3


Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, e lartcekura, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-8195
Më 2.7.2013

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, për lejimin e udhëtimit zyrtar për në Durrës dhe pagesës së mëditjeve për Nexhat Çoçajn, drejtor i DASH-së, kryetari i Komunës, më 2 korrik 2013, miratoi këtë:

V E N D I M

Neni 1

Lejohet udhëtimi zyrtar i Nexhat Çoçajt, drejtor i DASH-së, për në Durrës të Republikës së Shqipërisë, me qëllim të pjesëmarrjes në takimet punuese lidhur me Qeverisjen Elektronike në Komunitet e Kosovës. Trajnimi-takimet punuese do të mbahen nga data 2 korrik deri me 4 korrik 2013, kështu që për këtë qëllim lejohet udhëtimi zyrtar dhe pagesa e mëditjeve, për të lartcekurin.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve.

Neni 3


Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, i lartcekuri, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-8196
Më 2.7.2013

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Zyrës për Komunitete dhe Kthim, për lejimin e udhëtimit zyrtar për në Serbi dhe pagesës së shpenzimeve të akomodimit, ushqimit dhe pagesës së mëditjeve për Orhan Lopar, Ajradin Alija dhe Igballka Ramën (Fazlija), kryetari i Komunës, më 2 korrik 2013, miratoi këtë:

V E N D I M

Neni 1

Miratohet propozimi i Zyrës për Komunitete dhe Kthim, për lejimin e udhëtimit zyrtar të Orhan Lopar, Ajradin Alijes dhe Igballka Ramës (Fazlija) për pjesëmarrjen në projektin e quajtur "Shko dhe Informohu", me qëllim të vlerësimit në terren të familjeve - rasteve në Serbi. Vizita do të realizohet nga data 9 korrik deri me 12 korrik 2013 në disa qytete të Serbisë, kështu që për këtë qëllim lejohet udhëtimi zyrtar dhe mbulimi i shpenzimeve të akomodimit, ushqimit dhe pagesa e mëditjeve për të lartcekurit.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Zyrës për Komunitete dhe Kthim.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Zyra për Komunitete dhe Kthim dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Zyra për Komunitete dhe Kthim, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, të lartcekurit, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

